

UDHËZIM
Nr. 22, datë 4.10.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË
2.8.2013, TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISË SË NXËNËSVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe nenit 36, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 25, datë 2.8.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Nënkreu IV, i kreut 1, ndryshon si më poshtë:

“IV. Detyrat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka për detyrë:

a) të organizojë veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve t’u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës;

b) të organizojë veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës;

c) të organizojë veprimtari që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset vendimmarrëse;

d) të organizojë veprimtari që edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike;

e) të kontribuojë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës–nxënës, nxënës–mësues;

f) të kontribuojë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, bulizmin, si dhe të braktisjes së shkollës;

g) të kontribuojë në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale brenda dhe jashtë shkollës;

h) të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet grup-mosha e tyre;

i) të zgjedhë një herë në dy vjet nxënësit e shkollës, që do të kandidojnë për Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë, nga kuotat e përcaktuara për kategoritë e veçanta të nxënësve.”.

2. Në fund të titullit të nënkreut I, të kreut 2, hiqet togfjalëshi “dhe përbërja e saj”. Gjithashtu, pas pikës 8 të këtij nënkreu, shtohet pika 9, me përmbajtje si më poshtë:

“9. Kryetari i qeverisë së nxënësve duhet të përzgjidhet nga klasat 4–8 për arsimin bazë, ndërsa për arsimin e mesëm të lartë nga klasat 10–11, për të fituar të drejtën të kandidojë në zgjedhjet e Parlamentit të Nxënësve të Shqipërisë.”.

3. Pas nënkreut I, të kreut 2, shtohet nënkreu I/1, me përmbajtje si më poshtë:

“I/1. Përbërja e qeverisë së nxënësve

1. Qeveria e nxënësve ka kryetarin dhe sekretarin e saj.

2. Qeveria e nxënësve përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga nxënësit në bazë klase apo klasash paralele, sipas procedurave të parashikuara në nënkreun I të këtij kreu.

3. Kryetari i qeverisë së nxënësve:

a) drejton veprimtarinë e qeverisë së nxënësve;

b) drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të qeverisë së nxënësve;

c) drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve;

d) është përfaqësuesi i nxënësve në bordin e shkollës;

e) përfaqëson nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë saj;

f) shkarkohet nga detyra prej drejtorit të shkollës në rast të thyerjes së rregullores së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi.

4. Sekretari i qeverisë së nxënësve:

a) zgjidhet me shumicë votash në mbledhjen e parë të qeverisë së nxënësve;

b) përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;

c) mban shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve;

- d) lajmëron anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;
- e) mban arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.

5. Anëtari i qeverisë së nxënësve:

- a) komunikon mendimet e nxënësve që përfaqëson, në qeverinë e nxënësve;
- b) përcjell vendimet e qeverisë së nxënësve te klasa që përfaqëson;
- c) propozon nisma ose veprimtari, që mund të organizohen në nivel shkolle;
- d) merr pjesë rregullisht dhe është aktiv në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;
- e) raporton në çdo mbledhje te kryetari i qeverisë së nxënësve.”.

4. Nënkreu III, i kreut 2, ndryshohet si më poshtë:

“III. Veprimtari të qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve:

1. merr nisma për veprimtari jashtëkurrikulare jopolitike të nxënësve dhe i organizon ato në bashkëpunim me drejtorin e shkollës;

2. përgatit dhe realizon projekte, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, për plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;

3. përgatit dhe realizon projekte, pas miratimit të drejtorit të shkollës, edhe me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë në fokusin e tyre të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje dhe arsim;

4. zhvillon pyetësorë mbi kënaqësinë e nxënësve për shërbimin që shkolla siguron ose për aspekte të veçanta të jetës shkollore të nxënësve;

5. bashkëpunon me strukturat homologe të shkollave të tjera, brenda ose jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;

6. komunikon në mënyrë të vazhduar për veprimtarinë e saj me këshillin e prindërve;

7. harton planin vjetor, mbi bazën e përparësive të identifikuara nga të gjitha klasat e shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT.
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini